
PJESA II

Viktor Hygo

Katedralja e Parisit

Ciganes iu bë një pritje jashtëzakonisht e ftohtë. Zonjushat e këqyrën nga koka te këmbët, pastaj u panë sy në sy dhe kjo qe e mjaftueshme: ato e kishin kuptuar njëra-tjetrën. Ndërkaq vajza e re po priste t'i flisnin dhe ishte aq e turbulluar, saqë nuk guxonte të ngrinte qepallat.

Kapiteni e theu heshtjen i pari.

- Për fjalë të nderit, - tha ai me tonin e tij mendjemadh dhe disi të paturpshëm, - ja një krijesë magjepsëse!
Ç'thoni ju, e bukur kushërirë?

Kjo vërejtje, të cilën një adhurues me ndjenja pak më të holla do ta kishte bërë me gjysmë zëri, nuk mund ta zhdukte natyrisht, xhelozinë femërore, që kishte ngritur krye pas ardhjes së ciganes.

Flër-de-Lisi iu përgjigj kapitenit si me mospërfillje:

- S'është e keqe!

Të tjerat po pëshpëritnin me shoqja-shoqen.

Më në fund, zonja Aloizë, që ishte shqetësuar po aq sa të tjerat, jo për vete po për të bijën, tha:

- Afrohu këtu, vogëlushe.
- Afrohu këtu, vogëlushe! – përsëriti me një dinjitet komik Beranzhera, që mezi i arrinte

ciganes deri te beli.

Cigania u afrua te ajo zonjë aristokrate.

- Çupëlinë e lezetshme, - tha kapiteni rëndë-rëndë, duke bërë disa hapa drejt saj, - nuk e di nëse e meritoj lumturinë e lartë të më njihni...

Vajza ia ndërpreu fjalën duke i buzëqeshur atij dhe duke i hedhur një vështrim plot ëmbëlsi.

- Oh, po! – u përgjigj ajo.
- Paska kujtesë të mirë, - vërejti Flër-de-Lisi.
- Po sa shpejt krisët e ikët atë natë! – vijoi Febysi. – Mos ndoshta patët frikë prej meje?
- Oh, jo! – u përgjigj cigania.

Mënyra se si u shqiptua kjo “oh, jo!”, pas asaj “oh, po!”-je, kishte në vetvete njëfarë theksimi të veçantë, që e lëndoi Flër-de-Lisin.

- Ju ikët o bukuroshe dhe në vendin tuaj latë një lolo fytyrëngryset, gungaç dhe qorr me një sy, që më duket se ishte kambanari i peshkopit, - vazhdoi të thoshte kapiteni, të cilit iu zgjidh gjuha menjëherë tani që po fliste me një vajzë sido-kudo. – më thanë se ai qenka i prapë si djalli vetë. Paska një emër për të qeshur, u quajtka “E premtja e zezë”, “E diela e Palmave”, as mua s'më kujtohet; shkurt, ka emrin e një feste fetare! Dhe ai pati guximin t'ju rrëmbente, thua se jeni krijuar për dhjakët! E bukur kjo! E çfarë dreqin donte prej jush ai hut? Eh, pa më thoni?
 - As unë s'e di – u përgjigj ajo.
 - Ç'paturpësi! Një kambanar të rrëmbejë një vajzë, si të ishte ndonjë viskont. Një harbut të ndjekë prenë e aristokratëve! Ku është parë e dëgjuar kjo! Sidoqoftë, ai e pagoi shtrenjtë këtë. Metr Piera Tortëryi është ustai më i mirë që ua rrjep lëkurën horrave, dhe unë mund t'ju them, në qoftë se keni qejf ta dëgjoni, se ai ia bëri copë kurrizin kambanarit tuaj.
 - I shkreti! – tha cigania, së cilës këto fjalë i kujtuan skenën që kishte parë te shtylla e turpit.
 - Kapiteni ia plasi gazit.
-